



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:070821

Datë: 22.01.2020

Numri i dokumentit: 00778204

P.nr.988/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale gjyqtari Adem Shabani, dhe zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.B nga Fsh. ... K. Ferizaj, për shkak të veprës penale shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2579-1/18 të datës 27.12.2018, në praninë e prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarës M.SH, si dhe të akuzuarit K.B, pas kthimit të lëndës përsëri në vendosje-rigjykim ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 14.01.2020 ku të njëjtën ditë publikisht shpalli, dhe mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari K.B i lindur me date ..., nga babai A... dhe nëna H... e gjinisë L..., me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj, i martuar, prind i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mban nr. personal ..., në paraburgim nga data 18.12.2018 deri më 01.02.2019.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datë 14.12.2018, rreth orës 14:00, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, konkretisht në shtëpinë e tyre, i pandehuri ka shkelur urdhrin për mbrojtje të dhënë sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, numër UM.nr.5/18 të datës 26.06.2018, i cili është në fuqi deri me date 26.06.2018, ndaj palës së mbrojtur-bashkëshortes së tij M.SH, në atë mënyrë që përkundër faktit se e ka të ndaluar ta shqetësojë, ofendojë, përul, godas, kërcënojë, sulmojë, ngacmojë, kontaktojë, komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi palën e mbrojtur e ka fyer me fjale banale “ ta q... nanën ” e më pas e ka sulmuar fizikisht duke e goditur me grusht në krahun e djathtë, me ç’rast të e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës.

- Me të këtë ka kryer veprën penale shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 par. 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

Gjykata në bazë të neneve 3, 7, 17, 41, 45,47,73, 74, 75, dhe 82, të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 450 të KPPK-së, e

G J Y K O N

- Të akuzuarit **K.B** i shqipton dënim me burgim ne kohëzgjatje prej pese / 3 / muaj, ku në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e qëndrimit ne paraburgim nga data 18.12.2018 e deri me date 01.02.2019.

- Konform nenit 47 paragrafi 1 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit pjesa e mbetur e dënimit me burg i zëvendësohet në dënime gjobë në lartësi prej 250 Euro / dyqind e pesëdhjetë euro / të cilin dënim me gjobë duhet ta paguaj në afat prej 90 / nëntëdhjetë /ditë, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Konform nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

- E dëmtuara M/H/SH, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk është udhëzuar pasi në shqyrtimin fillestar nuk i'u është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

- Obligohet i akuzuari të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me Aktakuzën PP/II nr.2597-1/18 të datës 27.12.2018 e ka ngarkuar të pandehurin K.B nga fsh. ... K. Ferizaj, për veprën penale shkelja e urdherave mbrojtës nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktgjykimin P.nr.1730/2018 datë 01.02.2019, të akuzuarin K.B, e shpall fajtor për kryerjen e veprave penale shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje, me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej pese / 5 / ku në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e qëndrimit ne paraburgim nga data 18.12.2018 e deri me date 01.02.2019, të cilin dënim i akuzuari do ta vuaje menjëherë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimit, mbrojtësi i të gjykuarit av. M.I në afatin ligjor ka ushtruar ankesë që Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1730/18 i dt.11.02.2019, me propozim që ky Aktgjykim të Abrogohet dhe çështja të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, respektivisht që i njëjti të ndryshohet ashtu që të gjykuarit të i shqiptohet dënim më i butë.

Gjykata e Apelit e Kosovës PA1.nr.293/2019 i datës 06.08.2019, në seancën e kolegjit e ka anuluar aktgjykimin, dhe çështjen penale i kthen të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje, me që aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale në dispozitën e nenit 384 par 1 pika 1.2 të KPPK-së, të cilat shkelje lidhen me nenin 39 par.2 të KPPRK-së e të cilat shkelje kjo Gjykatë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, kjo ngase aktgjykimi është përpiluar në kundërshtim me nenin 394 të KPPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës së gjykatës së shkallës së parë u konstatua se gjyqtari i shkallës së parë në këtë çështje juridiko-penale ka vendos në përbërje jo të rregullt penale pasi gjyqtari i çështjes nuk ka pasur të drejt të gjykoj në këtë çështje pasi ka vendos në seancën e më hershme i gjyqtarë i procedurës penale, ka vendos për vazhdimin e masës së paraburgimit kundër të akuzuarit me aktvendimin e të njëjtës gjykatë P.nr.1730/18 të datës 31.12.2018 ku janë bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës GJ.A.nr.176/2014 të datës 07.05.2015, ku në pikën i të këtij mendimi juridik parashihet se “Nuk mundë të jetë gjyqtar i vetëm, anëtarë i trupit gjykues, kryetar i trupit gjykues, në gjykatën e shkallës së pare, gjyqtari i cili ka caktuar-vazhduar paraburgimin.

Nga arsyet e lartë cekura për rigjykim nga shkrimorja divizionit penale shkresave të kësaj lënde penale janë bartur tek gjyqtari tjetër gjykues.

Gjykata në këtë çështje penale në rivendosje ka caktuar seancë gjyqësore me datën 14.01.2020, dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor i ka njoftuar palët arsyet e kthimit kësaj lënde përsëri në rivendosje në këtë çështje penale dhe ka ftuar të akuzuarin që të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor si dhe e ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 par.2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

I akuzuari K.B pas njoftimit nga ana e gjykatës ka deklaruar se në këtë çështje penale i kishte dhen autorizim mbrojtësit të tij avokatit M.I që të më përfaqëson në procedure penale por pas kthimit në rigjykim të kësaj çështje penale heqë dorë që të kam mbrojtës për shkak të kushteve ekonomike dhe mbrojtjen do ta jap vetë.

Gjyqtari ka ftuar prokurorin e shtetit Avdullah Abedini për të lexuar aktakuzën me të cilën është ngarkuar i akuzuari .

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi përmbajtjen e aktakuzës dhe të njëjtiti i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij për veprën penale për të cilën është ngarkuar.

I akuzuari K.B lidhur me te drejtën për tu deklaruar me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, edhe në rigjykim të kësaj çështje penale në fillim të shqyrtimit gjyqësor deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale që akuzohem, i vije keq për atë që i ka ndodhë të dëmtuarës bashkëshortes së tij i kërkon falje publike, nga ky rast m te nuk ka pasur më problem ka premtuar se ndaj saj më asnjëherë nuk do të përsëris veprime të tilla kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të mere parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe t'i shqiptojë një dënim me të lehtë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vlerash qe në këtë shqyrtim gjyqësor pas pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit se janë përmbushur kërkesat nga neni 326 par 4 te KPPK-se dhe shqyrtim gjyqtar te vazhdoj me fjalën përfundimtare.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini ne fjalën përfundimtare deklaroi se pas pranimit te fajësisë nga ana e të akuzuarit K.B i akuzuar për veprën penale shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje, i akuzuari ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 të KPPRK-së i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden ne shkresën e lëndës siç janë, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Divizioni Civil UM.nr.5/18 datës 26.06.2018, mbi caktimin e urdhrave mbi masën mbrojtëse, si dhe fotove që gjinden në shkresat e lëndës andaj ne baze të këtyre provave u vërtetuar gjendja faktike si dhe kualifikim juridik i veprës penal te përshkruar ne diapozitivin e kësaj aktakuza, i propozim gjykatës qe te njëjtin ta shpalla fajtor dhe te dënoj sipas ligjit.

E dëmtuara M.SH në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike, tani me bashkëshortin- K... nga ky rast më nuk ka pasur problem dhe me te kanë një djal tani i mbush dymbëdhjetë vjet ku bashkëshorti kujdeset për mua dhe dalin dhe me punën që bënë privat na siguron mbajtjen tone andaj i propozoj gjykatës që me rastin e dënimit të mere për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese.

I akuzuari K.B në fjalën përfundimtare i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të mere për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese pas është mbajtes i familjes ku maksimalisht pas këtij rasti është kujdesur për të dëmtuarën-bashkëshorten dhe djalin e tij dhe në të ardhmen gjithëherë do të jem i kujdesshëm në veprimet e tija, i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të mere për pazë të gjitha rrethanat lehtësuese .

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit K.B ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 25 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje, ashtu siç është theksuar në dispozitiv te këtij aktgjykimi, te përshkruar në datën, vendin, kohen dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, ndërsa si rrethana rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim ne kohëzgjatje prej pesë / 3 / muaj, ku në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e qëndrimit ne paraburgim nga data 18.12.2018 e deri me date 01.02.2019. Konform nenit 47 paragrafi 1 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit pjesa e mbetur e dënimit me burg i zëvendësohet në dënime gjobë në lartësi prej 250 Euro / dyqind e pesëdhjetë euro / të cilin dënim me gjobë duhet ta paguaj në afat prej 90 / nëntëdhjetë /ditë, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga

dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit mbështetur në nenin 41 të KPPRK-së.

Konfrom nenit 461 paragrafi 1 të KPPRK-së të dëmtuarën M/H/SH, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk është udhëzuar në kontest civil me që e dëmtuara në shqyrtimin fillestar nuk i'u është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe taksën konform nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.988/19 me datë 14.01.2020

Zyrtare ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:070821
Datë: 22.01.2020
Numri i dokumentit: 00778204